

Date 24.04.2025

**Procesverbal - Tipi i kontratës – Shërbime**

**PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE  
KRITEREVE PËR KUALIFIKIM**

*(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)*

**Objekti i procedurës: “ Shërbim interneti për UKT sh.a ”**

KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV): shërbimet e internetit. 72400000-4

**Vlera e fondit limit : 1.992.917** (nje milion e nenteqind e netedhjetë e dy mijë e nenteqind e shtatëmbëdhjetë ) **Lekë, pa TVSH**

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, autoriteti/enti kontraktor UKT sh.a ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

a. *Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8*

b. *Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3;përkatësisht në vlerën është 39.858,34 tridhjetë e nente mijë e teteqind e pesëdhjetë e tete presje tridhjetë e kater) lekë.*

**Argumentimi:** Kërkesat e mësipërme bazohen në nenet 76, 82 dhe 83 të LPP, nenit 26, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”

**2.Kandidati/Ofertuesiduhettëdorëzohë:**

**2.2 Kapaciteti ekonomik-financiar**

2.2.1. Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare 2022, 2023, 2024 ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se 40% të fondit limit.

Kërkesa për plotësimin e kapaciteteve financiare konsiderohet e përmbushur nëse operatorët ekonomikë arrijnë vlerën e xhiros minimale, në të paktën një vit të periudhës së kërkuar nga autoriteti/enti kontraktor.

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, të VKM-së nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” e ndryshuar

Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë:

$$1.992.917 \times 40\% = 797.166,8$$

---

*Shënim: Duke qenë se aktet ligjore dhe nënligjore parashikojnë një marzh për vlerën e xhiros që mund të kërkohet, autoritetet/entet kontraktore duhet të argumentojnë vlerën e kërkuar të xhiros brenda këtij marzhi.*

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar në nenin 43, pika 1, pika 2, si dhe neni 64 i Ligjit Nr. 9920, datë 19.5.2008 (i ndryshuar) “Per Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë”, Udhëzimit të Ministrit të Financave nr.5, datë 30.01.2006, "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, VKM-së nr. 922 datë 29.12.2014 "Për deklarimin e detyrueshëm të deklaratave tatimore dhe të dokumenteve të tjera tatimore, vetëm nëpërmjet forms elektronike".

**2.2.2** Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë pasqyrat financiare vjetore (bilancet) gjatë 3(tre) viteve të fundit (2022, 2023, 2024) të çertifikuara nga organet tatimore. Në rast se operatori ekonomik është në kushtet e përcaktimeve të nenit 41, të ligjit nr.10091, datë 05.03.2009, atëherë bilancet duhet të shoqërohen edhe me akt-ekspertizën e ekspertit kontabël të autorizuar. Kjo kërkesë konsiderohet e përmbushur nëse në dy bilance të njëpasnjëshme, nuk ka raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivit

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e bilanceve është bërë duke iu referuar legjislacionit të fushës, konkretisht në nenin 29, pika 1 të Ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat" i ndryshuar si dhe kërkesave të Ligjit nr. 25/2018 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”.

**2.2.3.** Operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetim për shlyerjen e taksave vendore të parashikuara nga Pushteti Vendor për vitin 2025, ku të përfshihet kësti për periudhën përkatëse të maturuar sipas ligjit nr.9632 datë 30.10.2006”Për sistemin e taksave vendore”i ndryshuar;

**(lidhur me afatet e kryerjes se pagesave te caktuara nga njesite e veteqeverisjes vendore per vitin 2025),**

*(Në çdo rast AK ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme mbi vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga operatori ekonomik ose ti kërkojë operatorit ekonomik sqarime dhe dokumente mbështetëse për këto sqarime.*

**2.2.4.**Në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomikë, çdo anëtar i grupit duhet të dorëzojë vërtetimin lëshuar nga Autoriteti përkatës në të cilën është regjistruar sipas QKB.

Për përmbushjen e këtij kriteri, operatorët ekonomikë duhet të vetëdeklarojnë se ka paguar detyrimet e taksave vendore për vitin 2025 sipas ligjit nr.9632, datë 30.10.2006 në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit të DST-së objekt prokurimi.

Në cdo rast AK ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme mbi vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga operatori ekonomik ose ti kërkojë operatorit ekonomik sqarime dhe dokumente mbështetëse për këto sqarime.

**Shënim:** Ndërsa operatori ekonomik i kualifikuar duhet të dorëzojë pranë AK, **përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve ankimit**, të gjithë dokumentacionin provues për vetëdeklarimet në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit.

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, pika 6, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” e ndryshuar dhe në ligjin nr.9632, datë 30.10.2006 “Për Sistemin e Taksave Vendore” i ndryshuar, në ligjin nr.9920 date 19.05.2008 “Per procedurat tatimore” i ndryshuar, neni 4, pika 2 d).

Për përmbushjen e këtij kriteri, operatorët ekonomikë duhet të vetëdeklarojnë se ka paguar detyrimet e taksave vendore për vitin 2025 sipas ligjit nr.9632, datë 30.10.2006 në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit të DST-së objekt prokurimi.

Në cdo rast AK ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme mbi vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga operatori ekonomik ose ti kërkojë operatorit ekonomik sqarime dhe dokumente mbështetëse për këto sqarime.

**Shënim:** Ndërsa operatori ekonomik i kualifikuar i pari duhet të dorëzojë pranë AK, **përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve ankimit**, të gjithë dokumentacionin provues për vetëdeklarimet në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit.

Referuar sa mësipër, njësia e prokurimit gjykon se kriteri i vendosur nga autoriteti kontraktor lidhur me dorëzimin nga ana e operatorëve ekonomikë të vërtetimit të shlyerjes së detyrimeve vendore për vitin 2025 pranë bashkise/ve ku operatori ekonomik ushtron aktivitetin e tij është në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi e konkretisht me ligjin nr.9632, datë 30.10.2006 për “Sistemin e Taksave Vendore” i ndryshuar. Të gjithë subjektet që ushtrojnë veprimtari biznesi kanë detyrimin ligjor të regjistrimit pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit për të bërë të

identifikueshëm vendodhjen e aktivitetit të tyre dhe për tju nënshtruar pagesës së taksave vendore të parashikuara shprehimisht në këtë ligj.

## **2.5Aftësitë teknike dhe profesionale:**

2.3.1 Shërbime te ngjashme me objektin e prokurimit me vlerë jo më të vogël se 20% e vlerës së përlllogaritur të kontratës që prokurohet përkatësisht 398.583,4 (treqind e nentëdhjete e tete mije e peseqind e tetëdhjete e tre presje kater) lekë pa tvsh të kryera gjatë tri viteve të fundit (përlllogaritur nga data e shpalljes të njoftimit të kontratës)

Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmitë e mëposhtme:

- a) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin publik, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës dhe fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara ne orgamet tatimore ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara,
- b) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe në nenin 55, pika 4/b), të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” e ndryshuar.

Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që shërbimet e mëparshme të ngjashme të jenë ne vlerën jo më pak se 20 % të vlerës së fondit limit, që është brenda vlerës kufirit të përcaktuar në nenin e sipërcituar.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar për kontratat e ngjashme argumentohet si më poshtë:

$$1.992.917 \times 20\% = 398.583,4$$

---

2.3.2 Operatori ekonomik duhet të ketë të punësuar minimumi 6 (gjashtë) punonjes staf teknik me certifikimet e mëposhtme në forme të kombinuar të cilët do të angazhohen në realizimin e procedurës së prokurimit :

-1(nje ) punonjes te pajisur me certifikate SCTE ose ekuivalent

-1(nje) punonjes te certifikuar si Auditor per sistemet e menaxhimit te sgurise se informacionit

-2(dy) specialist te certifikuar nga Cisco ose ekuivalent per pajisjet e rrjetit .

-1(nje) punonjes te pajisur ,e certikate CS PS Core network planning ose ekuivalent.

Për të dëshmuar përmbushjen e kriterit të mësipërm operatori ekonomik duhet të paraqesë dokumentacionin e mëposhtëm:

a)Listë pagesat e punonjësve të plotësuar rregullisht sipas formatit e përcaktimeve që kërkohet nga legjislacioni në fuqi për muajin e fundit

b)Vërtetimin për numrin e punonjësve të siguruar per muajin e fundit të lëshuar nga administrata tatimore.

**Argumentim: Arsyetim teknik për përfshirjen e kriterit të punonjësit me certifikatë SCTE në procedurën me objekt “Shërbim Interneti”:**

Përfshirja e këtij kriteri synon të garantojë që operatori ekonomik disponon kapacitetin teknik dhe burimet njerëzore të nevojshme për të realizuar me cilësi të lartë shërbimin e kërkuar, si dhe të sigurojë përputhshmëri me kërkesat teknike të projektit dhe standardet e industrisë.

Nje punonjes I certifikuar ka njohuri të avancuara dhe të përditësuara mbi:

- Arkitekturën e rrjeteve të bazuara në fibra optike;
- Protokollet dhe standardet e transmetimit të të dhënave në rrjete broadband ();
- Praktikat më të mira në instalim, konfigurim dhe mirëmbajtje të infrastrukturës së shërbimit të internetit;
- Zbatimin e standardeve ndërkombëtare të sigurisë dhe performancës në rrjetet e komunikimit elektronik.

Ky kriter gjithashtu ndihmon në parandalimin e defekteve të mundshme gjatë periudhës së zbatimit të kontratës dhe ul ndjeshëm rrezikun e ndërprerjeve apo mosfunksionimit të shërbimit, duke pasur parasysh ndjeshmërinë dhe rëndësinë e tij për funksionimin normal të njësisë kontraktuese.

- **Arsyetim teknik për përfshirjen e kriterit të një punonjësi me certifikatë të vlefshme CISCO në procedurën me objekt “Shërbim Interneti”:**

Përfshirja e këtij kriteri synon të sigurojë që operatori ekonomik të ketë burimet njerëzore me **kapacitete të vërtetuara në menaxhimin e infrastrukturës së rrjetit**, çka është e domosdoshme për të garantuar vazhdimësinë, sigurinë dhe performancën e shërbimit të internetit që do të ofrohet.

Gjithashtu sipas dokumentit zyrtar **“Udhëzues për zbatimin e praktikave të mira për sigurinë e rrjeteve dhe sistemeve të informacionit”** miratuar nga AKCESK, për ofruesit e shërbimeve kritike ose esenciale të rrjeteve (përfshirë ISP-të), kërkohet:

**“Sigurimi i kapaciteteve teknike njerëzore të certifikuara për administrimin e rrjeteve dhe sigurinë e tyre, përfshirë certifikata ndërkombëtare të tilla si CISCO, CompTIA, ISO27001, etj.”**

*(AKCESK – Praktikati e Mira, 2022, Kreu III – Siguria Operacionale)*

Këto kërkesa lidhen ngushtësisht me zbatimin e detyrimeve që burojnë nga **Ligji nr. 2/2017 “Për sigurinë kibernetike”**, si dhe aktet nënligjore që synojnë të garantojnë funksionimin e pandërprerë dhe të sigurt të shërbimeve të internetit, në veçanti për institucionet publike dhe sistemet e tyre të informacionit.

Si perfundim, kjo kërkesë ul ndjeshëm rrezikun për ndërprerje të shërbimit, probleme teknike të paadresuara në kohë apo implementim të pasaktë të zgjidhjes së rrjetit, duke qenë se punonjësi i certifikuar me CISCO ka ekspertizën e nevojshme për të përballuar sfidat teknike që lidhen me këtë lloj shërbimi.

- **Arsyetim teknik për përfshirjen e kriterit të një punonjësi me certifikatë “CS PS Core Networking” në procedurën me objekt “Shërbim Internet”:**

Duke pasur parasysh kërkesat teknike dhe kritike që lidhen me ofrimin e një shërbimi interneti të besueshëm dhe me performancë të lartë, përfshirja si kriter i një punonjësi me **certifikatë të vlefshme “CS PS Core Networking”** përbën një masë të justifikuar për të siguruar kapacitetin teknik të operatorit ekonomik që do të zbatojë kontratën.

Duke qenë se pjesa më e rëndësishme e një shërbimi interneti kalon përmes rrjetit “core”, prania e një punonjësi me këtë certifikim siguron që operatori të jetë në gjendje të projektojë dhe mirëmbajë infrastrukturën e rrjetit në përputhje me **standardet më të larta të industrisë së telekomunikacionit**.

Për më tepër, kjo përgatitje teknike është kritike për të garantuar:

- Kohë minimale të ndërprerjes së shërbimit, adaptim të menjëhershëm me rritjen e kërkesave për trafik, si dhe siguri dhe stabilitet të vazhdueshëm për përdoruesit fundorë.
- **Arsyetim teknik për përfshirjen e një punonjësi të certifikuar si auditor për sistemet e menaxhimit të sigurisë së informacionit (p.sh. ISO/IEC 27001 Auditor)**

Shërbimi i internetit që do të ofrohet përfshin jo vetëm transmetimin e të dhënave, por edhe ndërveprimin me sisteme të brendshme IT të institucionit, të cilat mund të përmbajnë informacion të ndjeshëm, personal ose të klasifikuar. Kjo e bën **sigurinë e informacionit** një kërkesë kritike në kontratë.

Për këtë arsye, përfshirja si **kriter kualifikimi i një punonjësi të certifikuar si auditor për sistemet e menaxhimit të sigurisë së informacionit** (p.sh. **ISO/IEC 27001 Lead Auditor, Certified ISMS Auditor**, etj.) është teknikisht e justifikuar dhe në përputhje me kërkesat ndërkombëtare për siguri të informacionit.

Ky profil siguron kompetencat për:

- **Vlerësimin dhe kontrollin** e zbatimit të politikave dhe masave të sigurisë sipas standardeve ISO/IEC 27001;
- **Identifikimin e risqeve** që lidhen me rrjedhje të mundshme të informacionit gjatë transmetimit përmes rrjetit;
- Zbatimin e **protokolleve të enkriptimit**, autentifikimit dhe aksesit të kontrolluar mbi të dhënat;
- Monitorimin e përputhshmërisë me kërkesat ligjore dhe rregullatore (p.sh. GDPR, ligji për mbrojtjen e të dhënave personale, etj.);

2.3.3 Operatori ekonomik duhet të jete i regjistruar prane regjistrin te Autoritetit te Komunikimeve Elektronike dhe Postare si sipemarrës ofron rrjete dhe shërbime publike te komunikimeve elektronike sipas regjimit te autorizimit te pergjithshem ,per te plotesuar kete kriter OE duhet te dorezoje certifikaten e leshuar nga AKEP,te vlefshme per cdo shërbim qe do te ofroje.

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, nenin 41, pika 4, gërma b), gërma c) të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” e ndryshuar. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë fuqinë punëtore të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit, që ka në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën.

Nisur nga preventivi objekt prokurimi, pikave të shpërndara në qytetin e Tiranës ku do të realizohet shërbimi i kërkuar, si dhe defekteve teknike që mund të ndodhin gjatë realizimit të shërbimit si dhe duke parë rëndësinë e këtij shërbimi për shoqërinë e Ujësjellës Kanalizime Tiranë është e domosdoshme që operatori me të cilin mund të lidhim kontratë të ketë kapacitete teknike dhe burime njerëzore mëse të mjaftueshme për të përmbushur kërkesat teknike konform nenit 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, nenin 41, pika 4, gërma b), gërma c) të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” e ndryshuar.

Referuar numrit të kërkuar për zbatimin e kontratës objekt prokurimi njësia e prokurimit është referuar specifikimeve teknike të depozituara nga njësia e IT si dhe 37 pikave të shpërndara që mund të hapen në qytetin e Tiranës.

Duke iu referuar pikave të shpërndara në Tiranë e gjykon të nevojshme numrin e inxhinierëve të kërkuar në DT jo vetëm për instalimin në terren por edhe për konfigurimin dhe suportin e vazhdueshëm teknik gjatë gjithë vitit.

**Shënim:** Për pikat 2.3.2. -2.3.3 (a) dhe (b), më sipër operatorët ekonomik ofertues duhet të paraqesin formularin e vetëdeklarimit sipas shtojcës nr.10.

Në cdo rast AK ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme mbi vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga operatori ekonomik ose ti kërkojë operatorit ekonomik sqarime dhe dokumente mbështetëse për këto sqarime.

**Shënim:** Ndërsa operatori ekonomik i kualifikuar i pari duhet të dorëzojë pranë AK, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve ankimit, të gjithë dokumentacionin provues për vetëdeklarimet në formularin përmbledhës të vetëdeklarimi

2.3.4. Rrjeti i komunikimeve elektronike (Data dhe Internet) të operatorit duhet të bazohet në teknologjinë IP-MPLS. Për të dëshmuar përmbushjen e kriterit të sipërcituar operatori ekonomik duhet të paraqesë një deklaratë me anë të së cilës deklaron se rrjeti i komunikimeve elektronike bazohet në teknologjinë IP-MPLS.

Referuar kriterit të sipërcituar është e nevojshme përdorimi i kësaj teknologjie pasi mënyra e operimit dhe e kalimit të të dhënave është e tillë nga drejtoria qendrore drejt pikave dhe anasjelltas.

2.3.5. Operatori duhet të disponojë rrjet backbone të mbrojtur nga disa drejtime në mënyrë që të menjanohen problemet në rastin e dëmtimit të një drejtimi. Për të dëshmuar përmbushjen e kriterit të sipërcituar operatori ekonomik duhet të paraqesë një deklaratë me anë të së cilës deklaron se disponon rrjet backbone të mbrojtur nga të gjitha drejtimet.

***Kërkesa për një “rrjet backbone, të mbrojtur nga disa drejtime” i shërben AK për të siguruar për vazhdueshmerinë e shërbimit, në mënyrë që OE të ketë rrjetin e tij të mbrojtur, në mënyrë që shërbimi për UKT të mos afektohet nga dëmtimet në rrjetin backbone të operatorit. Për pika e prezencës së operatorit e cila ofron shërbim për një pikë të UKT, duhet të marrë shërbim nga dy drejtime të ndryshme.***

2.3.6. Operatori ofertues duhet të ketë të paktën 1 (një) lidhje ndërkombëtare për shërbimin e internetit. Për të vërtetuar këtë pikë, operatori ekonomik duhet të paraqesë një kopje të kontratës/marrëveshjes me subjektet jashtë territorit të Shqipërisë, mbi përdorimin e aksesit ndërkombëtarë të internetit.

***Theksojmë se objekti i prokuruar është “Shërbim Internet” dhe ky shërbim sigurohet vetëm nëpërmjet kontratave dhe lidhjeve ndërkombëtare për shërbimin e internetit. UKT duhet të***



*sigurohet qe OE te kete uplink te mjaftueshem dhe nga operatore te ndryshem ne menyre qe mos mbetet pa sherbim edhe nese ndonjera nga lidhjet e uplink peson defekt dhe kthehet si single point of failure. Kjo duke qene se nderprerjet e lidhjeve me operatoret nderkombetare mund te kene kohe te gjate riparimi (pasi nuk jane kompetence e OE).*

2.3.7.Operatori duhet te kete jo me pak se 20 GB bandwidth te kontraktuar me operatoret nderkombetare.

Për të dëshmuar përmbushjen e kriterit të sipërpërmendur operatori ekonomik duhet të paraqesë një kopje të kontratës/marrëveshjes me subjektet jashtë territorit të Shqipërisë.

2.3.8.Operatori duhet te ofroje sherbim pa perdorur rrjetin e operatoreve te tjere Për të dëshmuar përmbushjen e kriterit të sipërcituar operatori ekonomik duhet të paraqesë një deklaratë me anë të së cilës deklaron se shërbimi i ofruar (rrjeti)nuk i përket operatorëve të tjerë.

2.3.9 Operatori duhet te disponoje strukture Helpdesk te dedikuar, te kontaktueshem 24/7/365.

Për të dëshmuar përmbushjen e kriterit të sipërcituar operatori ekonomik duhet të paraqesë një deklaratë me anë të së cilës deklaron se disponon strukturë helpdesk të dedikuar të kontaktueshëm 24/7/365.

2.3.10.Operatori duhet te ofroje monitorim IP SLA te linkut. Për të dëshmuar përmbushjen e kriterit të sipërcituar operatori ekonomik duhet të paraqesë një deklaratë me anë të së cilës deklaron se ofron monitorim IP SLA të linkut.

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, nenin 41, pika 4, gërma ç), të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” e ndryshuar.

**Në të gjitha rastet kur përmendet certifikatë ,markë,emër i veçantë ,patentë,vizatim ose tip,origjine specifike,prodhues ose sipërmarrës pranohet edhe ekuivalent i tyre.**

**Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara.**

Rastet e mosparaqitjes së një dokumenti, ose dokumente false dhe të pasakta, konsiderohen kushte për skualifikim.

## **ARGUMENTIM MBI SPECIFIKIMET TEKNIKE**

UKT sh.a ne funksion te permisimit te cilesise se sherbimit ndaj klienteve kerkon blerjen e sherbimit internetit nje sherbim qe behet cdo vit per te pasur lidhje me te gjitha arkat dhe pikat e shperndara ne territorin e Tiranës .Pa kete sherbim nuk kemi arketime apo sherbime tjera qe UKT sha u ofron klienteve te saj. Me shtimin e pikave apo kujdesit ndaj klientit dhe shtrirjen territoriale kerkohet nje shpjetesesi interneti me e madhe dhe nje sherbim me cilesor nga i meparshmi per te rritur sigurine ne komunikim .

Linja kryesore e transmetimit e të gjitha pikave përfshirë dhe zyrat qendrore është e kërkuar (vetëm) me fibër optike , në rastet e këputjes së fibrës për qëllime të vazhdimësisë së procesit të punës dhe sigurimit të sinjalit të internetit duke shmangur pamundësitë fizike kërkojmë mbulimin e sinjalit të linjës back up me data sim e cila futet në punë në mënyrë automatike në rastet e dëmtimeve fizike.

Në këtë mënyrë shmangim çdo vonesë që mund të sjellë riparimi fizik i fibrës optike si dhe evitojmë bllokimin e procesit të punës i cili është i bazuar tërësisht në shërbimin e internetit.

### **Njesia e prokurimit**